



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-090

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
NR. 03/L-098 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
NR. 03/L-098 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL**

Neni 1

1. Neni 3 i ligjit bazik përkufizimi **“Bujqësia”** zëvendësohet me **"Aktivitet bujqësore"**.
2. Neni 3 i ligjit bazik përkufizimi **"Fermë"** zëvendësohet me **“Pronë bujqësore"**.
3. Neni 3 i ligjit bazik, përkufizimi **“Njësia e Pagesave”** zëvendësohet me përkufizimin si në vijim:

Agjencia - Agjencia për zhvillimin e bujqësisë për mbështetjen e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, e themeluar me këtë ligj.
4. Neni 3 i ligjit bazik pas përkufizimit **“Qeveria”** shtohen përkufizimet si vijon:

Fermer - personi fizik ose juridik përgjegjës për menaxhimin e fermës. Ai mund të jetë pronari, anëtari i familjes, qiradhënësi ose dikush tjetër i cili ka të drejtë të menaxhojë fermën;

Grup lokal i veprimit - entiteti ligjor i përbërë nga njerëz me përvojë, dhe të përkushtuar nga gjithë sektorët socio-ekonomikë të komunitetit të regjistruara në Ministrinë përgjegjëse;

IACS - Sistemi i Integruar i Administratës dhe Kontrollit;

Zonat më pak të favorizuara - zona të papërshtatshme agroklimatike, me teren të vështirë për t'u arritur e për t'u punuar, siç është lartësia mbidetare dhe shpatijet, ku fermerët për shkak të vështërsive natyrore ballafaqohen me shpenzime shtesë për shfrytëzimin e tyre;

SLPIS - Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës dhe softuerin përkatës për skicimin e parcelave të shfrytëzuesve të tokës dhe futjen e të dhënave për parcela në serverin qendror.

Parregullsi - veprimi ose mosveprimin nga ana e aplikantit ose e përfituesit i cili shkelë ligjet shtetërore, dispozitat, përcaktimet ose vendimin mbi përkrahjen dhe kështu dëmton fondet publike të Kosovës;

Mashtrim - çdo vepër e qëllimshme ose mospërfillje lidhur me:

1. shfrytëzimin ose paraqitjen e deklaratave ose dokumenteve të rrejshme, jokorrekte ose të pakompletuara të cilat kanë ose mund të kenë ndikim negativ në Buxhetin e Kosovës;
2. mosparaqitjen e informatave, duke shkelur një obligim specifik, me të njëjtin efekt që ka ndikim negativ në Buxhetin e Kosovës;
3. përdorimin e fondeve të tilla për qëllime tjera nga ato për të cilat është dhënë granti fillimisht.

Neni 2

Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.7. shtohen dy nënparagraf të rinj 1.8 dhe 1.9 me tekstin si në vijim:

1.8. përkujdesja që të ketë furnizim të qëndrueshëm në ushqim;

1.9. përkujdesja që të ketë furnizim për konsumatorët me çmime të arsyeshme.

Neni 3

Neni 5 i ligjit bazik fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

Neni 5

Plani kombëtar i bujqësisë dhe zhvillimit rural

1. Plani kombëtar i bujqësisë dhe zhvillimit rural, përcakton objektivat e hollësishme afatmesme dhe veprimet e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

2. Plani nga paragrafi 1 i këtij neni përmban:

2.1. strategjinë e bujqësisë dhe të zhvillimit rural i cili bazohet në analizën aktuale dhe objektivat afatmesme të politikës bujqësore dhe zhvillimit rural;

2.2. programet dhe veprimtaritë për përmbushjen e këtyre objektiveve;

2.3. fondet publike të nevojshme të përdorura për zbatimin e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural;

2.4. masat e nevojshme për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të programit.

3. Plani kombëtar i bujqësisë dhe zhvillimit rural hartohet, nga Ministria në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse.

4. Plani hartohet, nga Ministria aprovohet nga Kuvendi i Kosovës për një periudhë shtatë (7) vjeçare.

Neni 4

Neni 6 i ligjit bazik fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

Neni 6

Raporti vjetor për bujqësinë dhe zhvillimin rural

1. Ministri i prezanton Qeverisë, jo më vonë se deri më 30 shtator, raportin për zhvillimin dhe gjendjen ekonomike të bujqësisë për vitin paraprak.
2. Raporti vjetor për bujqësinë do të analizojë gjendjen ekonomike të pronave bujqësore sipas llojeve të pronave, madhësinë dhe zonat e prodhimit, marrëdhëniet në mes bujqësisë dhe mjedisit të përgjithshëm ekonomik, zhvillimi i tregtisë së jashtme me prodhimet bujqësore dhe ndikimet në vlerësimin e programeve përkrahëse.
3. Ministria mund të angazhojë institucione profesionale adekuate për elaborimin e raportit vjetor për bujqësinë.

Neni 5

1. Neni 7 i ligjit bazik paragrafi 1 pas nënparagrafit 1.2 shtohet nënparagraf i ri 1.3. me tekstin si në vijim:

1.3. Fondet e BE-së;

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.3. rinumërohet si 1.4.

Neni 6

Neni 8 i ligjit bazik fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

Neni 8

Përfituesit nga masat mbështetëse

1. Përfituesit nga masat mbështetëse, të cilat ndërmerren në kuadrin e politikës së bujqësisë dhe të zhvillimit rural janë fermerët - grupet e fermerëve ose grupet lokale të veprimit.
2. Ministria me akt nënligjor i përcakton kriteret që duhet përmbushur nga përfituesit për zbatimin e masave individuale në bujqësi dhe zhvillim rural.

Neni 7

1. Neni 9 i ligjit bazik paragrafi 1 pas togfjalëshit “**grup fermerësh**” shtohet fjalia “**ose grup lokal i veprimit**”, ndërsa fjalia “**personat fizik apo juridik siç parashikohet me këtë ligj.**” fshihet nga teksti i ligjit.

2. Neni 9 i ligjit bazik pas paragrafi 2. shtohet paragrafi i ri 3. me tekstin si në vijim:

3. Në rast të keqpërdorimit nga paragrafi 2 i ligjit në fuqi, përfituesi, duhet kthyer fondet sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 8

Neni 10 i ligjit bazik fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

Neni 10 Verifikimi i kritereve përzgjedhëse

1. Verifikimi i kritereve të pranueshmërisë përbëhet nga kontrollet administrative, kontrollet të ndërmarra në teren dhe në baze të kërkesave për pagesa.

2. Procedurat sigurojnë regjistrimin e të dhënave të monitoruara, rezultatet e verifikimit dhe masat e ndërmarra lidhur me dallimet në mes të të dhënave të prezantuara dhe gjendjes faktike në teren.

3. Për verifikimin e kritereve të pranueshmërisë atje ku është e aplikueshme, merren parasysh rezultatet e verifikimit të ndërmarrë nga shërbimet tjera, organet ose organizatat e përfshira në kontrollet e pagesave direkte dhe granteve bujqësore

4. Ministria me akt nënligjor e përcakton mënyrën dhe nivelin e kontrolleve në teren për masat individuale në bujqësi dhe zhvillim rural.

Neni 9

Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 1. togfjalëshi “**për një periudhë katër (4) vjeçare**” zëvendësohet me togfjalëshin “**për një periudhë tre (3) vjeçare**”.

Neni 10

Pas nenit 11 të ligjit bazik shtohet neni i ri 11.A me tekstin si në vijim:

Neni 11.A

Themelimi i Agjencisë për zhvillimin e bujqësisë

1. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë themelohet nga Ministria.
2. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë menaxhohet nga kryeshefi ekzekutiv nën autoritetin e Ministrisë.
3. Ministria me akt nënligjor e përcakton funksionimin, detyrat, përgjegjësitë, kompetencat, dhe strukturën organizative të Agjencisë.

Neni 11

Neni 12 i ligjit bazik fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

Neni 12

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

1. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është përgjegjëse për zbatimin e politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural.
2. Agjencia është kompetente për:
 - 2.1. zbatimin e masave të politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural;
 - 2.2. zbatimin e procedurave të pagesave që sigurojnë që pagesat të bëhen vetëm për aplikacionet që janë të arsyetuara dhe që përmbushin kriteret e pranueshmërisë;
 - 2.3. sigurimin e kontabilitetit të plotë dhe transparent sipas procedurave të pranuarra të kontabilitetit;
 - 2.4. hartimin e raporteve dhe analizat në pajtim me zhvillimin bujqësor;
 - 2.5. ndërtimin dhe funksionimin e IACS;
 - 2.6. ndërtimin dhe zbatimin e sistemit informativ për tregjet;
 - 2.7. krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së nevojshme të të dhënave;
 - 2.8. zbatimin e kontrollit dhe masave të auditimit të brendshëm;

2.9. inspektimin e fermerëve që kanë përfituar nga fondet e programit për bujqësi dhe zhvillim rural.

3. Agjencia zbaton programet ndërkombëtare përkrahëse për zhvillimin e bujqësisë.

4. Përfundimisht dispozitave të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, Agjencia mund të delegojë kompetenca të caktuara për zbatimin e masave përkrahëse për politikën e bujqësisë dhe zhvillimit rural te institucionet tjera përmes kontratave të shkruara, por Agjencia mbetet përgjegjëse për detyrat e deleguara.

Neni 12

1. Titulli i Kreut III fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

KREU III MASAT E POLITIKËS SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

2. Neni 13 i ligjit bazik fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

Neni 13 Parimet mbi të cilat bazohen masat e politikës bujqësore

1. Masat e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural bazohen në Planin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
2. Masat e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural zbatohen në bazë të objektivit dhe kriterit jodiskriminues në pajtim me parimet e barazisë dhe efektivitetit.
3. Masat bazohen në parimet e përputhshmërisë dhe plotfuqishmërisë.
4. Çdo mbivendosje mes masave, duhet të shmanget dhe asnjë shpenzim nuk do të financohet në më shumë se një masë.
5. Masat përgatiten me objektiva të qarta dhe të verifikueshme.
6. Për të siguruar transparencë të mjaftueshme, kriteret përkrahëse publikohen në media dhe në Web faqen e Ministrisë.
7. Agjencia për çdo vit publikon listën e përfituesve, emrin, masën dhe shumën e dhënë përfituesit.

Neni 13

1. Pas Neni 13 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 13.A me tekstin si në vijim:

Neni 13.A Masat e politikave bujqësore

1. Masat e politikës bujqësore do të:

1.1 shtojnë të ardhurat për fermerët dhe popullsinë rurale që ndikojnë në përmirësimin e standardit të jetesës dhe kushteve të punës në viset rurale;

1.2 rrisin aftësitë konkurruese dhe efikasitetin e prodhimit primar bujqësor për të arritur zëvendësimin e importit dhe për të shfrytëzuar përparësinë e tregjeve të eksportit;

1.3 sigurimi i mjedisit stabil ekonomik.

Neni 14

1. Neni 14 i ligjit bazik fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

Neni 14 Format e mbështetjes së brendshme

1. Masat mbështetëse për prodhimet bujqësore dhe agro-ushqimore zbatohen për të rritur prodhimin bujqësor, të ardhurat dhe stabilizimin e tregut.

2. Masat e politikave bujqësore zbatohen në tërë territorin e Republikës së Kosovës për të siguruar kushtet e njëjta për fermerët dhe parandalimin e çrregullimit të konkurrencës.

Neni 15

Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 2 dhe 3 fshihen nga teksti i ligjit, ndërsa paragrafi 1 mbetet në fuqi.

Neni 16

1. Pas nenit 16 të ligjit bazik shtohet neni i ri 16.A, me tekstin si në vijim:

Neni 16.A

Përkrahja për përmirësimin e menaxhimit të tokës dhe mbrojtjen e mjedisit

1. Përkrahja për përmirësimin e menaxhimit të tokës dhe mbrojtjen e mjedisit do të jenë lidhur me masat që synojnë shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, përmes:

1.1 Pagesat për fermerët në zonat më pak të favorizuara që janë identifikuar, të cilat mund të jepen vetëm si kompensim për shpenzimet shtesë të prodhimit.

1.2 Pagesat agro-mjedisore përfshirë pagesat për përkrahjen e prodhimit organik, të cilat mund tu jepet fermerëve që tregojnë përkushtim vullnetar agro-mjedisor, duke përmbushur standardet e obligueshme përkatëse.

2. Ministria me akt nënligjor i përcakton zonat më pak të favorizuara, të cilat mbështetën në bazë të kriterëve objektive dhe jo diskriminuese.

Neni 17

1. Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3, me tekstin si në vijim:

3. Ministria me akt nënligjor i përcakton kriteret për mbështetje të grupeve lokale të veprimit.

Neni 18

1. Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 2. fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

2. Qeveria me akt nënligjor e përcakton përbërjen, detyrat, përgjegjësitë dhe organizimin e Komitetit Ndërmintoror për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Neni 19

1. Neni 20 i ligjit bazik, paragrafi 1 pas nënparagrafit 1.6. shtohen tre nënparagraf të rinj 1.7, 1.8 dhe 1.9, me tekstin si në vijim:

1.7. regjistrin e përfituesve;

1.8. regjistrin e SLPIS dhe

1.9. regjistrin e zonave më pak të favorizuara.

2. Neni 20 i ligjit bazik, paragrafi 4 fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

4. Ministria me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe mënyrën e mirëmbajtjes, sigurinë dhe procedurat administrative të bazës së të dhënave.

Neni 20

1. Neni 37 i ligjit bazik paragrafi 1, togfjalëshi “**udhëheqësit të inspektionit përkatës**” zëvendësohet me togfjalëshin “**Kryeshefit të Agjencisë**”.

2. Neni 37 i ligjit bazik, paragrafi 2 fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

2. Kundër vendimit të Kryeshefit të Agjencisë, pala mund të paraqesë padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Neni 21

1. Pas nenit 37 të ligjit bazik shtohet neni i ri 37.A me tekstin si në vijim:

Neni 37.A Procedurat

Për zbatimin e masave të politikës për bujqësinë dhe zhvillimit rural zbatohet Ligji Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, (Gazeta Zyrtare Nr.08/2007 e dt.01/01/2007) përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj apo me akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 22

1. Pas nenit 38 të ligjit bazik shtohet neni i ri 38.A me tekstin si në vijim:

Neni 38.A

1. Ndëshkimet në rast të parregullsive, bëhen si vijon:

1.1 E tërë shuma e përkrahjes kthehet sipas ligjit;

1.2 Përveç obligimit të kthimit të pagesës sipas nenit 7 të këtij ligji, përfituesi mund të përjashtohet nga programet përkrahëse deri në tri (3) vite në bazë të vendimit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë nëse ekziston së paku njëri nga kushtet e përcaktuara kur përfituesi:

1.2.1 nuk i ka përmbushur obligimet e përfshira në vendim;

1.2.2 nuk i ka zbatuar qëllimet e përcaktuara në vendim;

1.2.3 ka paraqitur të dhëna të rrejshme lidhur me projektin;

1.2.4 ka penguar kontrollin zyrtar të projektit të Ministrisë;

1.2.5 nuk e ka paguar tërësisht apo pjesërisht përkrahjen e pranuar pa të drejtë.

2. Përjashtim nga programet përkrahëse përfshin edhe përjashtimin nga të gjitha programet e dhëna nga Ministria.

Neni 23 Zbatimi

Për zbatimin e këtij ligji, Ministria obligohet që në afat prej dymbëdhjetë (12) muajve të nxjerr aktet nënligjore.

Neni 24 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-090
13 shtator 2012**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI